



Bisedo, luaj, lexo

Aktivite argëtuese dhe të thjeshta për të mbështetur komunikimin dhe zhvillimin gjuhësor të foshnjave dhe të vegjëleve

Në partneritet me



Change your story



Bisedo, luaj, lexo

Tri mënyra të thjeshta për të bërë që fëmija yt të fillojë më mirë jetën



Nëse të pëlqejnë aktivitetet në këtë broshurë, do të të pëlqejë buletini ynë! Ky do të arrijë çdo dy javë me aktivitetet më të fundit të bisedës, luajtjes dhe leximit, lajmet e fundit dhe shumë të tjera!

Regjistrohu në faqen tonë në internet:
[wordsforlife.org.uk/newsletter](https://www.wordsforlife.org.uk/newsletter)



Aktivite të thjeshta, argëtuese për fëmijët

Shumë gjëra të vogla ndriçojnë trurin e fëmijëve

Fëmijët marrin gjithçka. Edhe gjërat më të vogla që bëni me ta mund të sjellin një ndryshim të madh për t'i bërë gati për ditën kur fillojnë shkollën.



Askush nuk e njeh fëmijën tënd më mirë se ti. Zgjidh idetë që janë të përshtatshme për ty, ndrysho aktivitetet tona ose krijo të tuat.



Ne e dimë se ti je e njeh më mirë fëmijën tënd. Disa nga këto aktivitete mund të zgjatin minuta, ndërsa të tjerat mund të zgjatin më shumë. Ne duam që ti dhe fëmija yt t'i shijoni këto aktivitete, prandaj të lutemi, mos u ndje nën presion nga koha ora. Mund të kthehesh në çdo moment. Ndiq drejtimin e fëmijës tënd.



Përdor **#ChatPlayRead** për të ndarë foto dhe video, të tutë dhe të vogëlushit tënd duke bërë aktivitetet e përshkruara në këtë broshurë. Për çdo aktivitet ka edhe një video, kështu që, për më shumë informacion, ti mund të skanosh kodet QR. Na pëlqen të shohim se si familjet i përdorin idetë tona në të gjithë vendin!

Përmbajtja

Aktivite bisede	5
Ndërrimi i pelenave dhe biseda	6
Dita e mëparshme	8
Vozit, vozit, vozit varkën tënde	9
Loja e kujtesës	11
Aktivite lojërash	13
Peek-a-boo	14
Argëtim duke bërë banjë	15
Krijo kutinë tënde të zërit	16
Zoom, zoom, zoom ne do të shkojmë në hënë	18
Aktivite leximi	20
Koha për të parë një libër	21
Shko së bashku me fëmijën për të blerë	23
Dita kur Teddy është jashtë shtëpisë	24
Vezullo, vezullo yll i vogël	26

Aktivitete bisede

Dita e mëparshme



Loja e kujtesës



**Vozit, vozit, vozit
varkën tënde**



**Ndërrimi i pelenave
dhe biseda**



Ndërrimi i pelenave dhe biseda



Biseda në kohën e ndërrimit të pelenave e ndihmon fëmijën tënd.



Fëmijës i pëlqen kur ju flisni me të. Duke biseduar dhe ndërruar shprehjet e fytyrës, ti krijon një lidhje dhe e ndihmon atë të mësojë për njerëzit.



Është mirë të dish se

Biseda me fëmijën tënd që nga dita e parë i jep atij mjetet e nevojshme për të mësuar të flasë dhe të kuptojë të tjerët.

Këshilla praktike për ndërrimin e pelenave




Buzëqesh.



Thuaj shprehje dhe bëj zhurma të ndryshme.



Thuaj shprehje dhe bëj zhurma të ndryshme. Fëmijës tënd i pëlqen të të shikojë dhe të të kopjojë. Nxirre gjuhën jashtë!



Përgjigju tingujve dhe shprehjeve të fytyrës të fëmijës tënd.



Qëndro i/e qetë në mënyrë që fëmija yt të jetë i qetë dhe të përqendrohet tek ti.



Provo t'i këndosh fëmijës një nga vjershat për fëmijë që të parapëlqejnë.

Dita e mëparshme



Të flasësh për atë që do të bësh në një ditë të caktuar e ndihmon fëmijën të mësojë.



Fëmijëve u pëlqejnë rutinat dhe duan të dinë se çfarë vjen më pas.

Në mëngjes, bisedo me fëmijën tënd për planet e tua. Këtë mund ta bësh kur e ushqen, e ndërron, gjatë një udhëtimi ose loje.

Një ide e mirë është të flasësh për gjërat sipas radhës që do të ndjekësh kur t'i bësh.

Për shembull: "Së pari do të vishemi, pastaj do të hamë mëngjes."

Ndërsa fëmija yt rritet dhe mëson të flasë, ti mund ta pyesësh nëse ai e di se çfarë do të ndodhë më pas. Atij mund t'i duhet kohë për të mësuar, por vetëm duke i bërë pyetje e ndihmon atë të kushtojë vëmendje.



Është mirë të dish se

Rutinat dhe njohja e asaj që do të ndodhë më pas na ndihmojnë të gjithëve të ndihemi të sigurt dhe në gjendje të mësojmë.

Vozit, vozit, vozit varkën tënde



Në këtë vjershë për fëmijë ka veprime dhe zhurma argëtuese për ta bërë fëmijën tënd të qeshë.




Ti mund t'i ndihmosh fëmijët më të vegjël me veprime të thjeshta, të tilla si mbajtja e tyre në prehër dhe kënga. Duke qenë se fëmija yt ka siguri kur ulet, ai do të jetë në gjendje të bëjë më shumë lëvizje dhe veprime në mënyrë të pavarur. Vetëm sigurohu që ai të ulet butë!

Ulu me fëmijën duke e pasur atë përballë teje dhe mbajti duart e tij. Lëvizja atij butësisht duart mbrapa dhe përpara kur ti "vozit". Kënaqu duke kërcitur, duke bërtitur ose duke ulëritur kur ti sheh miun, krokodilin ose luanin.



Është mirë të dish se

Kjo këngë ndihmon në aftësitë motorike të fëmijës tënd pasi ai vë në veprim të gjithë trupin për t'u lëkundur. Kjo mund ta ndihmojë atë për qëndrimin në ekuilibër dhe për zhvillimin e muskujve.



Vozit, vozit, vozit varkën tënde
Butësisht poshtë rrjedhës
Me gëzim, me gëzim, me gëzim, me gëzim
Jeta është thjesht një ëndërr.

Vozit, vozit, vozit varkën tënde
Butësisht mbi përrua.
Nëse sheh një mi të vogël
Mos harro të kërcesh!

Vozit, vozit, vozit varkën tënde
Butësisht poshtë lumit.
Nëse sheh një ari polar
Mos harro të dridhesh!

Vozit, vozit, vozit varkën tënde
Butësisht poshtë rrjedhës.
Nëse sheh një krokodil
Mos harro të bërtasësh!

Vozit, vozit, vozit varkën tënde
Butësisht në breg.
Nëse sheh një luan
Mos harro të ulërish!

Vozit, vozit, vozit varkën tënde
Butësisht poshtë rrjedhës.
Me gëzim, me gëzim, me gëzim, me gëzim
Jeta është thjesht një ëndërr.



Është mirë të dish se

Duke kënduar vjershat për fëmijë me fëmijën tënd e ndihmon atë të mësojë të flasë ndërsa i mësohet veshi me fjalët dhe ritmin. Ai mund të fillojë të imitojë tingujt që bën ti, ose të të shoqërojë me fjalët.

Loja e kujtesës



Kjo është një lojë e lehtë për t'u luajtur në shtëpi dhe e inkurajon fëmijën tënd të flasë, të mendojë dhe të luajë.



Kjo lojë argëtuese kujtese e ndihmon fëmijën tënd të komunikojë dhe të zgjidhë problemet. Fëmijët e vegjël mund të flasin për lodrat e ndryshme dhe të fillojnë t'i renditin ato, ndërsa më të mëdhenjtë kënaqen kur përpiqen të kujtojnë atë që mungon.




Është mirë të dish se


Kjo lojë ndihmon për ndërtimin e gjuhës, përqendrimit dhe kujtesës.

1


Grumbullo disa nga lodrat, librat dhe sendet e parapëlqyera të fëmijës tënd. Për këtë mund të të ndihmojë edhe ai vetë.

2

Bashkoi ato dhe bisedo për to.

3

Kërkoji fëmijës tënd të mbyllë sytë dhe të kthehet.

4

Hiq një nga sendet. Më pas thuaj fëmijës të hapë sytë dhe të shohë nëse mund të kujtojë se cili send mungon.



Tani e ke ti radhën

Ti mund ta luash këtë lojë duke bërë të kundërtën: fëmija yt të heqë një send dhe ti të testosh kujtesën tënde.

Aktivitete lojërash

Argëtim duke bërë banjë



Krijo kutinë tënde të zërit



Zoom, zoom, zoom ne do të shkojmë në hënë



Peek-a-boo

Peek-a-boo



Peek-a-boo është një lojë argëtuese që u pëlqen shumë fëmijëve të vegjël.



Është një lojë e mrekullueshme për të luajtur kur fëmija yt është i lumtur dhe i relaksuar. Ti mund ta luash këtë lojë me fëmijën tënd në prehër ose kur ai është shtrirë dhe i përqendruar tek ti. Luaj duke mbuluar fytyrën tënde me duar ose batanije. Pyete fëmijën: "Ku shkoi mami/babi/emri juaj?". Pastaj zbulo fytyrën dhe thuaj: "Peek-a-boo!"



Është mirë të dish se

Qëndrimi me barkun poshtë e ndihmon fëmijën tënd të forcojë muskujt, që do ta ndihmojnë atë të ulet, të zvarritet dhe të ecë. Nëse fëmijës tënd nuk i pëlqen qëndrimi me barkun poshtë, një lojë si kjo mund ta ndihmojë atë të argëtohet.

Argëtim duke bërë banjë



Koha e banjës është e përshtatshme për të biseduar dhe luajtur sepse fëmija yt shpesh është i relaksuar dhe vëmendja e tij nuk mungon.



Kopjo veprimet e foshnjës sate ose tingujt që nxjerr ajo dhe shiko se si reagon.

Fol për atë që po bën ti ndërkohë që je duke e bërë. Për shembull, kur është koha për të larë fytyrën, thuaj: "Koha për të larë fytyrën".

Nëse ajo bën banjë me një lodër, ti mund t'i bësh veprimet me lodrën. Për shembull, "Koha për t'i larë fytyrën rosës!"

Ti gjithashtu mund të imitosh veprimet. Shih nëse fëmija yt të kopjon apo bën zhurmë.



Është mirë të dish se

Sa më shumë të argëtoheni së bashku, aq më shumë do të mësojë fëmija yt.


Krijo kutinë tënde të zërit

Ka shumë mënyra për të bashkëvepruar me lodra ose fotografi. Një nga këto mënyra është duke nxjerrë tinguj.




Është mirë të dish se


Lojërat me tinguj e ndihmojnë fëmijën tënd të mësojë të dëgjojë më mirë, gjë që është e dobishme kur ai është gati për të komunikuar.

1


Grumbullo disa sende të njohura. Këto mund të jenë lodra ose fotografi të gjërave që i pëlqejnë fëmijës tënd. Këto do të futen në "kutinë e tij të zërit".

2

Më pas, vendosi sendet në një kuti (edhe një këllëf jastëku është i përshtatshëm).

3

Ulu me të voglin tënd dhe bëj zërin e diçkaje që është në kuti, p.sh. të një lope, duke bërë "mu" ose një makine, duke bërë "vrum". Kërkoji fëmijës tënd të gjejë lodrën që e bën atë zhurmë.

4

Nxite fëmijën të kërkojë në kuti dhe të gjejë gjënë e duhur. Kur ta gjejë, lëvdoje dhe thuaj se çfarë është ai send. Për shembull, "Bravo, e gjete lopën!"

Zoom, zoom, zoom ne do të shkojmë në hënë



Në këtë vjershë për fëmijë ka veprime dhe zhurma argëtuese për ta bërë fëmijën tënd të qeshë.




Ulu me fëmijën tënd në krahë dhe lëviz butësisht përpara dhe mbrapa. Trego qiellin dhe formo rrahë me krahë në rrugën tënde për në hënë. Kur numëron mbrapsht, ngrije zërin pas çdo numri që thua. Kur për ty dhe fëmijën të vijë çasti i "nisjes", ngrije atë lart në ajër.



Është mirë të dish se

Kjo këngë ndihmon në aftësitë motorike të fëmijës tënd, pasi ai përdor duart për të krijuar forma. Kjo mund ta ndihmojë atë për qëndrimin në ekuilibër dhe për zhvillimin e muskujve.



**Astronautë vini re
Ju lutemi, njoftoni anijen kozmike
Përgatitu për nisje
Faleminderit!
Zoom Zoom Zoom
Ne do të shkojmë në hënë
Zoom Zoom Zoom
Ne do të shkojmë në hënë
Nëse dëshiron të udhëtosh
Hip në anijen time kozmike
Zoom Zoom Zoom
Ne do të shkojmë në hënë
10 9 8 7 6 5 4 3 2 1**

U nisëm!

Në çastin e "nisjes",
ngrije fëmijën tënd lart në ajër.



Është mirë të dish se

Ti mund të gjesh libra me vjersha për fëmijë në bibliotekën e zonës tënde. Ndonjëherë bibliotekat kryejnë sesione falas për vjershat.

Aktivitete leximi

Koha për të parë një libër



Vezullo, vezullo yll i vogël



Shko së bashku me fëmijën për të blerë



Dita kur Teddy është jashtë shtëpisë

Koha për të parë një libër



Fëmijëve u pëlqen të shikojnë fotografitë dhe të dëgjojnë histori nga librat.



Gjetja e kohës çdo ditë për të parë një libër është e mirë për zhvillimin e fëmijës tënd. Kjo e ndihmon atë të përqendrohet dhe të mësojë fjalë. Është edhe një mundësi e mirë për një kohë të qetë dhe tërheqëse së bashku.

Ndërto një stufkë të rehatshme duke varur një batanije mbi një tavolinë dhe duke vendosur jastëkë poshtë. Mund të ndërtoësh edhe një stufkë jashtë. Të ndash një libër së bashku në një vend të papritur është emocionuese dhe fëmijët fillojnë t'i mendojnë librat si aventura.

Për të ndihmuar në ngjalljen e dashurisë për librat, mund të përfshish tregime në rutinën e të voglit tënd. Librat mund të jenë të dobishëm pak përpara gjumit. Shikimi i një libri në heshtje së bashku mund ta bëjë të kuptojë se është koha për t'u qetësuar. Ose mund të bëhet në mes të ditës - sa herë që ti mendon se ai ka nevojë për pak kohë të qetë.



Është mirë të dish se

Vizita në bibliotekë mund të jetë një përvojë sociale si për ty ashtu edhe për fëmijën tënd dhe ti vetë mund të gjesh shumë libra për fëmijë që mund t'i huazosh falas.

Këshilla praktike për kohën e librit

**Shiko një libër
në çdo kohë, por
jo në kohën kur
bie për të fjetur**

**Gjej një vend të
qetë**

**Fol për figurat
dhe lexo të
gjitha fjalët ose
disa prej tyre**

**Jepi fëmijës
tënd kohë të
përgjigjet**

**Përsëriti fjalët e
fëmijës tënd**

**Mos lexo për një
kohë të gjatë.
Ndalo kur fëmija
yt mërzhitet**

Shko së bashku me fëmijën për të blerë



Vajtja jote për blerje mund të jetë një shans për të biseduar me fëmijën tënd dhe për t'i treguar atij se shkronjat dhe fjalët janë kudo rreth nesh.



Fol me fëmijën tënd për gjërat që mund të shihni ndërsa ecni nëpër dyqane. Përshkruaj sendet që po merr dhe inkurajoje fëmijën tënd të bëjë të njëjtën gjë. Vër në dukje tabelat në dyqan, logot dhe etiketat. Kjo e ndihmon fëmijën tënd të kuptojë se shkronjat dhe fjalët kanë një qëllim.



Është mirë të dish se

Fëmija yt mund të dëshirojë të krijojë një listë blerjesh, veçanërisht nëse ai të shoh se ke një të tillë. Nxite fëmijën të bëjë një shenjë ose të vizatojë një figurë për secilin artikull. Në fillim ai mund të vizatojë vija ose forma.

Dita kur Teddy është jashtë shtëpisë



Koha e tregimit me lodrën që parapëlqen fëmija yt.



Ky aktivitet tregimi nuk përfshin asnjë libër. Ai e inkurajon fëmijën tënd të krijojë historinë e tij. Ti zgjidh së bashku me të një nga lodrat e tij të parapëlqyera, si një pelush apo një kukull. Bëje atë personazhin kryesor të tregimit.

Nëse ke ngecur për një ide historie, provo të krijosh një udhëtim me tren.



Është mirë të dish se

Krijimi i tregimeve ndihmon në kultivimin e kreativitetit dhe imagjinatës së fëmijëve

1 Fillo me emrin e lodrës dhe vendin ku jeton.

2 Më pas vazhdo të plotësosh vendet bosh:

Unë jam
një...

Unë jetoj në
një...

Unë jam duke
udhëtuar
me...

Shoku im
më i mirë
është...

Treni po më
çon...

Rrugës
pamë...

Krijë kërkesat e tua ndërsa po udhëtoni. Nuk ka rëndësi se sa naive është historia. Krijimi i tregimeve është argëtues dhe e ndihmon fëmijën tënd të mësojë të flasë dhe të përdorë imagjinatën.

Vezullo, vezullo yll i vogël

Në libra mund të gesh vjersha të ndryshme për fëmijë me muzikë. Muzika dhe të kënduarit janë një mënyrë e shkëlqyer për ta prezantuar fëmijën tënd me gjuhën që në moshë të re.



Ulu me fëmijën duke e pasur atë përballë dhe tregoji se si të lëvizë duart në mënyrë që të vezullojnë si një yll. Këndoji fëmijës tënd vjershën për fëmijë dhe krijo me gishta formën e një diamanti.



Është mirë të dish se

Muzika mund të ndihmojë në rritjen e aftësive të kujtesës dhe vëmendjes.

Përveç kësaj, ul stresin dhe mund të qetësojë fëmijën kur është i mërzitur.



Vezullo, vezullo, yll i vogël
Pyes veten se çfarë je ti
Aq lart mbi botën
Si një diamant në qiell
Vezullo, vezullo, yll i vogël
Pyes veten se çfarë je ti



Është mirë të dish se

Të kënduarit e vjershave për fëmijë së bashku me fëmijën tënd ndihmon aftësitë e tij gjuhësore, para leximit dhe shkrimit, ndërsa ai mëson të dëgjojë tinguj dhe fjalë të ndryshme në vjersha.

Më shumë ide për aktivitete argëtuese për t'ia shtuar rutinës sate,
mund të gjesh në:


[wordsforlife.org.uk](https://www.wordsforlife.org.uk)

[nhs.uk/start-for-life/early-learning-development](https://www.nhs.uk/start-for-life/early-learning-development)


Rreth National Literacy Trust


National Literacy Trust është një organizatë bamirëse e pavarur që fuqizon fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit në aftësitë e alfabetizimit, që u nevojiten për të pasur sukses.

Alfabetizimi ndryshon gjithçka. Ai jep mjetet për të përfituar sa më shumë nga jeta dhe fuqinë për të formuar të ardhmen tuaj. Të hap derën për jetën që dëshiron. Por alfabetizimi i ulët është i lidhur pazgjidhshmërisht me varfërinë. Gjatë 30 viteve të fundit, ne kemi vazhduar të punojmë me njerëzit që kanë më shumë nevojë për ne, duke mbështetur shkollat, familjet dhe komunitetet në nivel vendor dhe kombëtar.

 Na gjen në Facebook [/nationalliteracytrust](https://www.facebook.com/nationalliteracytrust)

 Na ndiq në X, dikur Twitter [@Literacy_Trust](https://twitter.com/Literacy_Trust)

 Na ndiq në Instagram [@Literacy_Trust](https://www.instagram.com/Literacy_Trust)

 Regjistrohu për buletin tonë falas me email në [literacytrust.org.uk/register](https://www.literacytrust.org.uk/register)

Në partneritet me

